



KOMUNA E GJAKOVËS

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur me dt.28 01.2019, ndërmjet:

1. Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (Voice of Roma, Ashkali and Egyptians) si Organizate Joqeveritare me numër të regjistrimit 5113364-1 pranë Ministrisë së Administratës Publike, me adresë në rrugën Milosa Obilica në Graçanicë, 10500 Prishtinë, të cilën e përfaqëson Drejtori Ekzekutiv Isak Skenderi, në tekstin vijues VORAE;
2. Komunës së Gjakovës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna;

1. Qëllimi i Marrëveshjes

Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe banimit së grupeve të marginalizuara me fokus tek romët, ashkallitë dhe egjiptianët dhe përmirësimi i situatës së tyre sociale në Komunën e Gjakovës.

Kjo ndërhyrje gjen bazën në Strategjinë Kombëtare për Përfshirjen e Romëve dhe Ashkalive 2017-2021, Plani Lokal i Veprimit të Komunës së Gjakovës dhe mbështetet me Projektin për Përfshirjen Sociale RAESI II të zbatuar nga Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptasve në bashkëpunim me Fondacionin Zviceran HEKS dhe Fondacionin Zviceran Terre des hommes dhe financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Prishtinë.

2. Kushtet e përgjithshme

OJQ VoRAE do të aplikojë qasjen e përmirësimit të shtëpisë të drejtuar nga banorët e projektuar dhe testuar në konsultime të ngushta me partnerët tanë zviceranë nga HEKS dhe SKAT dhe përshtatur për rrethanat dhe nevojat e Kosovës.

Parimi themelor është të sigurohet se familjet janë të lidhura me sistemet publike të ujit dhe kanalizimeve dhe që ata të kenë qasje në hapësirë adekuate të jetesës dhe banjo funksionale me ujë të ngrohtë.

Projekti parasheh këto modele për ndërtimin:

- a) MODELI 5: Riparime në shtëpitë ekzistuese prej 1.000 €.
- b) MODELI 4: Ndërtimin e banjos funksionale prej 1.500 €.
- c) MODELI 3: Riparime të shtëpisë ekzistuese ose ndërtimi i aneks hapësire banimit me banjo funksionale deri në 27 m² në kategorinë prej 3.500 €.
- d) MODELI 2: Riparime të shtëpisë ekzistuese ose ndërtimi i aneks hapësire banimit me banjo funksionale deri në 41 m² në kategorinë prej 4.800 €.
- d) MODELI 1: Shtëpi me banjo funksionale prej 60 m² në kategorinë prej 6.800 €.

Ndërsa OJQ-ja VORAE do të sigurojë të gjitha materialet e ndërtimit që kërkohen për të përfunduar ndërhyrjen bazuar në modelet e lartpërmendura, familja është e obliguar të kryejë të gjitha punimet e ndërtimit, përveç instalimit të ujit dhe energjisë elektrike, të cilat do të sigurohen nga Organizata.

Për të siguruar që cilësia minimale e ndërhyrjes zbatohet, OJQ-ja do të angazhojë masonët profesionistë për të monitoruar, udhëzuar dhe këshilluar familjet gjatë fazës së ndërtimit.

Buxheti i paraparë për përmirësimin i kushteve të jetesës dhe banimit të grupeve të marginalizuara me fokus tek romët, ashkalitë dhe egjiptianët dhe përmirësimi i situatës së tyre sociale në Komunën e Gjakovës në baze të kësaj marrëveshje është 52,000.00 €, nga i cili:

Komuna e Gjakovës do të ndaje 25.000.00 €, dhe

VORAE do të ndaje 27.000.00 €.

Mjetet financiare të përmendura më lart, Komuna e Gjakovës do të transferojë në xhirollogarinë e organizatës VORAE në me nr. **1167002199000133** në ProCredit Bankë.

Bartja e mjeteve prej nga Komuna e Gjakovës në llogarinë e organizatës VORAE do të bëhet si në vijim:

- Kësti i parë në shumën prej 33% nga totali i kontraktuar nga Komuna tek organizata VORAE bëhet pas nënshkrimit të marrëveshjes.
- Kësti i dytë në shumën prej 33% nga totali i kontraktuar nga Komuna tek organizata VORAE bëhet pasi që organizata VORAE të dorëzojë të gjitha faturat e kështit të parë tek Komuna e Gjakovës duke arsyetuar kështu shpenzimet e kështit të parë.
- Kësti i tretë në shumën prej 34 % nga totali i kontraktuar do të bëhet pasi që VORAE të dorëzojë të gjitha faturat e kështit të dytë tek Komuna e Gjakovës duke arsyetuar kështu shpenzimet e kështit të dytë dhe format e inspektimit final për të arsyetuar punën e ndërtimit në terren.

3. Veprimet konkrete te Komunës së Gjakovës

- Pas nënshkrimit të marrëveshjes Kryetari i Komunës së Gjakovës do të përcaktojë Departamentin Përgjegjës me të cilin VORAE do të ketë bashkëpunim të ngushtë.
- Komuna e Gjakovës duhet të publikojë shpalljen për aplikim të familjeve që kanë nevojë për ndërhyrjen e projektit.
- Do të autorizohet komisioni deri në 3 persona nga Kryetari i Komunës së Gjakovës, të cilët do të jenë të pranishëm në procesin e vizitave në familje dhe selektimin e tyre.

4. Veprimet konkrete te VORAE

- VORAE si OJQ implementuese do t'ia komunikojë Komunës vendimet dhe aktivitetet e kryera në Komunën e Gjakovës, dhe në rast nevojë do të kërkojë nga organet komunale të ndihmojnë në procesin e vendim-marrjes.
- VORAE do të koordinoj secilin aktivitet të implementuar në fushën përkatëse të projektit me departamentet përgjegjës të autorizuar nga Kryetari i Komunës.
- VORAE do të bëjë përzgjedhjen e kompanive për furnizim me material ndërtimorë me komision të përbashkët me pjesëtarët e Komunës në të cilat implementohet projekti i banimit.
- VORAE gjatë tërë procesit të ndërtimit do të monitorojë punimet tek familjet përfituese dhe në përfundim të punimeve ndërtimore është e obliguar të dorëzojë tek komuna dosjen me dokumentet të cilat arsyetojnë tërë procesin implementues si dhe kopjet e faturave për shpenzimet në vlerë prej 52.000.00 €.

5. Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit dhe është valide deri në përfundim të punimeve në ndërtimin e shtëpive, por jo më gjatë se deri në 31 Dhjetor 2019.

6. Kushtet e Veçanta

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është e plotfuqishme që nga Janar, 2019 deri në Dhjetor, 2019.

Kjo marrëveshje është bërë në dy kopje origjinale për secilën palë nga një formë.

Në rast se kjo marrëveshje nuk respektohet atëherë palët janë të obliguara të njoftojnë palën tjetër 30 ditë më herët për shpëputjen e marrëveshjes.

PALËT

Komuna e Gjakovës

Ardian Gjini

VORAE

Isak Skenderi